




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr. 29, datë 16.11.2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK
SHOQËRISË “ENERGJIA VALAMARA” SH.P.K**



Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Energjia Valamara”, sipas Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” Nr. 869 Rep. dhe Nr.398/1 Kol. datë 28.12.2015 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Subjektit për Qëllime të Veçanta, shoqërisë “Energjia Valamara”, Kontratën shtesë të Koncesionit Nr. 768 Rep. dhe Nr. 258 Kol. datë 07.08.2017 për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentralit “Selca 2 dhe Mesmal”, e ndryshuar, me zhvillues shoqërinë “Energjia Valamara” sh.p.k. Kontratën shtesë të Koncesionit Nr. 888 Rep. dhe Nr.262 Kol. datë 28.03.2022 për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentralit “Selca 2 dhe Mesmal”, e ndryshuar, me vendndodhje Lozhan Bashkia Maliq.



Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Mesmali 1

Vendndodhja e veprës së marrjes 1

- $X=542153.5$; $Y=4520345.9$; $Z=1650$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: $0.1 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore: $0.072 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: $0.015 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike: $0.004 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e veprës së marrjes 2

- $X=542160$; $Y=4519592.6$; $Z=1650$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: $0.2 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare vjetore: $0.09 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: $0.021 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike: $0.006 \text{ m}^3/\text{s}$

Vendndodhja e godinës së Centralit

- $X=545023.2$; $Y=4518018.9$; $Z=1145.5$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: $0.3 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prodhimi vjetor i parashikuar: $4.157.743 \text{ kwh/vit}$
- Fuqia e instaluar: 1177 kwh
- Vlera totale e investimit: $148,266,766.6$ lekë pa TVSH.

Koordinatat e pikës së shkarkimit, ku kanali i largimit të godinës së HEC-it, takon trupin ujqor pritës:

- $X=545041.8$ $Y=4518021.7$ $Z=+1144$ m.m.n.d. (KRGJSH)

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Leja me nr.722/1 prot., datë 04.07.2018 miratuar me vendimin nr.9 datë 21.06.2018 nga K.B.U Seman shfuqizohet.
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.



KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ